



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:102514

Datë: 18.04.2024

Numri i dokumentit: 05587920

C.nr.346/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtorin profesional Armond Qmega, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit L.K, nga fshati Hoçë e Vogël, Komuna e Rahovecit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati D.M nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokati B.O nga Rahoveci, me bazë juridike kompensimi i ushqimit dhe udhëtimit në punë, vlera e objektit të kontestit 2,053.60 euro, jashtë seancës, më datën 18.04.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit L.K, nga Rahoveci, me të cilën ka kërkuar që të “DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit L.K, nga fshati Hoçë e Vogël, Komuna e Rahovecit, në emër të kompensimit për ushqim në punë për periudhën kohore prej datës 10.02.2020 e deri më datën 23.03.2023 për 604 ditë pune të ja paguajë shumën prej 1,208.00 euro dhe në emër të kompensimit për udhëtim për periudhën kohore prej datës 10.02.2020 e deri më datën 23.03.2023 për 604 ditë pune të ja paguajë shumën prej 845.60 euro duke e llogaritur nga 70% e shumës prej 2 euro për çdo biletë (70% i 2 euro = 1.40 euro), me kamatë ligjore 8% nga data 03.05.2023 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm”.

DETYROHET paditësi L.K që të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, t’ia paguaj shpenzimet procedurale në shumën prej 104.00 euro, në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësi L.K, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, më datën 03.05.2023, në këtë gjykatë ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, kanë parashtruar padinë për kompensimin e ushqimit dhe udhëtimit në punë në shumën prej 2,053.60 euro.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në përgjigjen e saj në padi të datës 05.07.2023, ka theksuar se e kontestojmë padinë në tërësi për shkak se më 21.11.2022 MASHT-i ka shkëputur Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 21.01.2021 të lidhur me SBASHK. Padiësi ka parashtruar padi në gjykatë më 03.05.2023, me kërkesë për kompensimin e ushqimit dhe të udhëtimit sipas Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 21.01.2021 edhe pse i njëjti nuk është mësimdhënës dhe as i punësuar në arsim në kuptim të dispozitave të kësaj kontrate. Padiësi ka një kontratë të punës me Drejtorinë Komunale të Arsimit si shërbyes civil, i emëruar me Akt Emërim sipas Ligjit për Shërbimin Civil dhe i caktuar në pozitën Udhëheqës i Sektorit për Arsim. Këto të dhënat vërtetohen edhe me Listën e Pagave të punëdhënësit të muajit janar 2023. Ndërkaq kërkesat që dalin nga kontestet e marrëdhënies së punës fillimisht duhet të parashtrohen tek punëdhënësi. Gjykata mund të shqyrtoj një padi që ka elemente nga kontesti i marrëdhënies së punës vetëm nëse padiësit i kanë shtjerrur të gjitha mjetet në procedurë të rregullt pranë të paditurës si organ administrativ. Në këtë rast padiësit nuk kanë parashtruar kërkesë për kompensim pranë të paditurës. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e padiësit ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: kartela nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, kontrata e punës Republika e Kosovës, Kuvendi Komunal Rahovec, Njësia e Personelit, e datës 05.02.2019, vërtetimi i lëshuar nga SBASHKU, i datës 30.03.2023, Raporti i prezencës në punë për periudhën: 01.01.2020 – 23.03.2023, vërtetimin nga K, i datës Mars 2023, Certifikata e vendbanimit e datës 24.03.2023

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 dhe 398 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nuk ishte kontestues fakti se padiësi ka të themeluar marrëdhënien e punës tek e paditura. Në këtë çështje juridike kontestues mbetet fakti se a i takon padiësit pagesa e ushqimit dhe udhëtimit për çdo ditë të prezencës në punë.

Me administrimin e kartelës nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, vërtetohet se padiësi është anëtar i SBASHK-ut.

Me administrimin e Kontratës së punës Republika e Kosovës, Kuvendi Komunal Rahovec, Njësia e Personelit, e datës 05.02.2019, gjykata vërtetoi faktin se padiësi ka kontratë pune me të paditurën e i njëjti është i sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në Komunën e Rahovecit, si udhëheqës i sektorit për arsim.

Me administrimin e raportit të prezencës në punë për periudhën: 01.01.2020 – 23.03.2023, vërtetohet se i njëjti ka prezantuar në punë.

Me administrimin e vërtetimit e çmimit të biletës së udhëtimit i datës 20.04.2021, gjykata vërtetoi faktin se çmimi i biletës së udhëtimit në relacionin Hoçë e Vogël – Rahovec është 2 euro në dy drejtime.

Me administrimin e certifikatës së vendbanimit Nr. ser. B 10446732, e datës 24.03.2023, vërtetohet se paditësi jeton në fshatin Hoçë e Vogël, Komuna e Rahovecit.

Gjykata ka vendosur që ta refuzojë në tërësi kërkesëpadinë e paditësit për faktin se sipas vlerësimit të kësaj gjykate paditësi nuk është punonjës i cili është kategorizuar si punonjës i arsimit sipas Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe të datës 22.01.2021, por shërbyes civil, ashtu siç është kategorizuar me Ligjin për Shërbimin Civil. Sipas këtyre kontratave, në nenin 2 par.1 pika 1.1 parashihet që *“Dispozitat e kësaj Kontrate kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”*. Kjo dispozitë në mënyrë taksative i ka paraparë kategoritë të cilët janë përfitues të Kontratës kolektive sektoriale të arsimit në Kosovë.

Paditësi me të paditurën ka lidhur kontratë dhe i njëjti është i sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në Komunën e Rahovecit, si udhëheqës i sektorit për arsim, mbi këtë bazë i njëjti nuk është mësimdhënës, por shërbyes civil, i emëruar me akt emërim sipas Ligjit për Shërbimin Civil. Po ashtu paditësi në rend të parë kërkesëpadinë e tij e bazon në Kontratën e Përgjithshme Kolektive të Kosovës të datës 21.01.2021, duke prezantuar si provë që është anëtar i SBASHK-ut, këtë fakt gjykata nuk e morri për bazë ngase në nenin 5 të Kontratën e Përgjithshme Kolektive të Kosovës të datës 21.01.2021 parashihet se *“Anëtarë të sindikatës konsiderohen vetëm ata mësimdhënës, mësimdhënës universiteti, punonjës shkencorë, të kulturës apo personel ndihmës, që janë deklaruar me shkrim për anëtarësimin në SBASHK, nënshkrues i kësaj kontrate, dhe që paguajnë rregullisht anëtarësi sindikale sipas mënyrës dhe vlerës që përcaktohet nga organet drejtuese të SBASHK-ut”*. Po ashtu në dispozitat Kontratës Kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të arsimit parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë), qendrat burimore në kuadër të MASH-it dhe qendrat e kompetencës në kuadër të AAPARR), shtëpitë e studentëve dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut. Dispozitat e kësaj Kontrate kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e arsimit, (komunat - DKA-të, KD-të - universitetet, institucionet e arsimit të lartë, shtëpitë e studentëve, qendrat burimore në kuadër të MASH-it, qendrat e kompetencës, në kuadër të AAPARR, MASH-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 399.1 të LPK-së, ku parashihet se *“kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija”*.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, nenit 399 të LPK, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit dhe 452.1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC

Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil

C.nr.346/2023, më datën 18.04.2024

Bashkëpunëtor profesional
Armond Qmega

Gjyqtari
Berkan Hamza

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.